



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES

Nr. 265/3 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

VENDIM
Nr. 13 Datë 26.11.2025

PËR

**“MIRATIMIN E FONDIT BUXHETOR PËR STUDENTËT TË CILËT DO TË VLIJOJNË
TË PËRFITOJNË MBËSHTETJE FINANCIARE, EDHE PËR VITIN AKADEMIK 2025-
2026”**

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në nenin 11 dhe pikën 3, të nenit 112, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në gërmën “ç”, të pikës 6, të Vendimit nr.397, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”, në pikën 4, dhe 7, të Vendimit nr.386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në pikën 11, të Udhëzimit nr.30, datë 04.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit buxhetor për 260 studentë, të cilët do të vijojnë të përfitojnë mbështetje financiare, edhe për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI
Erzen TOLA

ANËTARËT

Besmir HAKAJ

Artan HOXHA

Agron KASA

Spiro BRUMBULLI